



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 98

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 11 qershor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 94, datë 30.5.2024	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 60, datë 9.5.2022, “Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave” 10627
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 95, datë 30.5.2024	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përdorimin e kartës së posaçme në njësitë tregtare ushqimore ose rrjetet e tyre nga punonjësit e Policisë së Shtetit..... 10627
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 102, datë 5.6.2024	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës..... 10629
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 96, datë 31.5.2024	Për caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë..... 10636
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 405, datë 4.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Moldavisë..... 10637
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 406, datë 4.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë..... 10639
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 407, datë 4.6.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 269, datë 8.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Suedisë” 10640
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 408, datë 4.6.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 113, datë 14.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Sllovakisë” 10640
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 409, datë 4.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Moldavisë..... 10640

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 20.5.2024	Mbi fillimin e procedurës, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	10641
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 20.5.2024	Mbi fillimin e procedurës, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	10642
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Aleksandër Tiri.....	10643



UDHËZIM
Nr. 94, datë 30.5.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 60, DATË 9.5.2022,
“PËR PËRBËRJEN DHE
FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË
VLERËSIMIT TË GRADAVE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 60, datë 9.5.2021, “Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 2, shkronja “c”, riformulohet si më poshtë:

“c) Drejtuesi i drejtorisë përgjegjëse për burimet njerëzore, anëtar”.

2. Në pikën 3, shkronja “b”, riformulohet si më poshtë vijon:

“b) Përfaqësues i drejtorisë përgjegjëse për burimet njerëzore, anëtar”.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

UDHËZIM
Nr. 95, datë 30.5.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE PROCEDURAVE PËR
PËRDORIMIN E KARTËS SË POSAÇME
NË NJËSITË TREGTARE USHQIMORE
OSE RRJETET E TYRE NGA
PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të vendimit të Këshillit të ministrave nr. 189, datë

15.3.2017, “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe shtetasve të ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të drejtën e pajisjes me kartë të posaçme, e ka çdo punonjës i Policisë së Shtetit i cili përfiton kompensim financiar, në rastet e përcaktuara në vendimin nr. 189, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre”, të ndryshuar.

2. Kompensimi financiar i jepet punonjësit të Policisë së Shtetit në llogarinë e posaçme të hapur në një nga bankat e nivelit të dytë, sipas zgjedhjes së tij, që në përputhje me rregullat dhe kriteret e këtij udhëzimi, mund të lëshojnë një kartë të posaçme për përdorimin vetëm në njësitë tregtare ose rrjetet tregtare të tyre dhe që mund të përdoret vetëm për blerjen e produkteve ushqimore. Për qëllime të këtij udhëzimi, me produkt ushqimor kuptohet çdo produkt i tregtuar nga njësia tregtare ose rrjetet e tyre, që përmban ushqim, që shërben si ushqim ose që përdoret për përgatitjen e ushqimit.

3. Karta e posaçme duhet të jetë e lidhur me një llogari bankare të posaçme që nuk lejon kryerjen e veprimeve të tjera bankare përveç se kreditimin e kompensimit financiar, në masën e përlllogaritur nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, si dhe debitimin e saj nga njësitë tregtare ushqimore ose rrjetet e tyre, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve të pikave të shitjes (POS – *Point of Sale*), ose nëpërmjet përdorimit të sistemeve *online* të blerjes, vetëm për produktet ushqimore. Për këtë qëllim, llogaria e posaçme ose karta e posaçme nuk duhet të lejojë tërheqjen e parave fizike, në sportelet e bankës ose nëpërmjet bankomateve (*ATM – Automatic Teller Machine*), transfertat dalëse në llogari të tjera ose çdo lloj veprimi tjetër bankar që transferon fondet nga llogaria, me qëllim kryerjen e transaksioneve bankare të ndryshme nga blerja e produkteve ushqimore.

4. Punonjësi i Policisë së Shtetit hap llogarinë e posaçme në ato banka të nivelit të dytë që:

a) nuk aplikojnë komisione për hapjen e llogarisë së posaçme, pajisjen me kartën e posaçme apo



ripajisjen me të, në rastet e humbjes, vjedhjes ose dëmtimit, si edhe gjatë përdorimit të kartës së posaçme për çdo transaksion;

b) garantojnë të drejtën e përdorimit të gjendjes së llogarisë së posaçme pa kufizime në kohë, ose në limitin e blerjeve;

c) të sigurojë kontrollin e gjendjes së llogarisë së posaçme, si dhe transaksioneve që janë kryer prej saj, nëpërmjet platformës digjitale (*e-banking*) të bankës së nivelit të dytë;

ç) të garantojë ekzekutimin e fondeve brenda të njëjtës ditë pune, sipas veprimeve të kryera nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit;

5. Bankat e nivelit të dytë, që punonjësi i Policisë së Shtetit ka përzgjedhur për të hapur llogarinë bankare, duhet t'i sigurojë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ose Ministrisë së Brendshme raporte periodike, ose me kërkesë mbi:

a) masën e fondeve të përdorura nga punonjësit e policisë së shtetit, përkundrejt fondit total të kredituar tek punonjësit e policisë së shtetit që kanë përzgjedhur bankën përkatëse për hapjen e llogarisë së posaçme;

b) në bashkëpunim me njësitë tregtare ushqimore, ose rrjetet e tyre, raporte të detajuara për përdorimin e fondit sipas qëllimit të përcaktuar, përfshirë edhe kategorinë e produkteve ushqimore të blera dhe sasinë e tyre.

6. Banka e nivelit të dytë, që përzgjidhet nga punonjësi i Policisë për të hapur llogarinë bankare, duhet të sigurojë që karta e posaçme të funksionojë me çdo njësitë tregtare ushqimore, ose rrjetet e tyre që plotëson kushtet teknike për përdorimin e kartës së posaçme. Në çdo rast, në krijimin e kushteve teknike për ndërlikdhjen e sistemit të pajisjeve të pikave të shitjes (*POS – Point of Sale*), ose nëpërmjet përdorimit të sistemeve *online* të blerjes të njësisë tregtare ushqimore, ose rrjeteve të tyre, me llogarinë e posaçme bankat e nivelit të dytë i japin përparësi njësisve tregtare ushqimore, ose rrjeteve të tyre që sigurojnë ulje jo më pak se 5 përqind të të gjitha kategorive të produkteve ushqimore, në raport me çmimin e zakonshëm të shitjes së tyre për konsumatorët e tjerë, si dhe uljen jo më pak se 10 përqind të produkteve të shportës.

7. Njësitë tregtare ushqimore ose rrjetet e tyre i paraqesin kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe bankave të nivelit të dytë, që punonjësit e policisë së shtetit kanë hapur llogari të posaçme sipas këtij udhëzimi, për përdorimin e

kartës së posaçme në njësitë e tyre tregtare ushqimore, bashkërisht me uljet e propozuara për çmimet e artikujve të produkteve ushqimore. Bankat e nivelit të dytë sigurojnë që të krijojnë kushtet teknike për përdorimin e kartës së posaçme nëpërmjet POS-it ose sistemit të blerjeve *online* të njësisë tregtare ushqimore, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së miratimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit jep miratimin për krijimin e kushteve teknike për përdorimin e kartës, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës, duke u bazuar në plotësimin e kushteve ligjore nga njësia tregtare ushqimore përkatëse, për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe duke siguruar që të ketë njësi tregtare ushqimore që janë të ndërlikdhura me bankat e nivelit të dytë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Në rast se një nga bankat e nivelit të dytë nuk përmbushin detyrimet e përcaktuara në këtë udhëzim, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk transferon fondet në llogarinë e posaçme të punonjësit të policisë, por i kërkon hapjen e llogarisë së posaçme në një nga bankat e nivelit të dytë që përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim.

9. Me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësit të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit njofton bankën e nivelit të dytë se llogaria e punonjësit të Policisë së Shtetit nuk do të kreditohet në vazhdimësi për efekt të kompensimit financiar të trajtimit me ushqim.

10. Punonjësi, të cilit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në Policinë e Shtetit, ka të drejtë të vendosë nëse llogaria e hapur do të mbahet aktive për kryerjen e transaksioneve financiare për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë udhëzim ose të disponojë për mbylljen e saj.

11. Karta e posaçme është e vlefshme për aq sa zgjasin marrëdhëniet e punës të punonjësit në Policinë e Shtetit.

12. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi përballohen nga buxheti i policisë së shtetit.

13. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Taulant Balla



UDHËZIM
Nr. 102, datë 5.6.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
DHE PROCEDURAVE PËR
PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT PËR
DREJTOR TË PËRGJITHSHËM
TË GARDËS SË REPUBLIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat që lejojnë ministrin e Brendshëm të kryejë një proces objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen, renditjen dhe propozimin e kandidatëve për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

2. Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes bazohet dhe respekton parimin e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit.

Neni 2
Procesi i përgjithshëm i përzgjedhjes

1. Propozimi për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë bëhet pas kryerjes së një procesi të hapur, i cili organizohet nga Ministria e Brendshme.

2. Ministria e Brendshme shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës, jo më vonë se 30 ditë nga data e krijimit të vendit vakant. Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit qëndron e hapur për 15 ditë.

3. Ministria e Brendshme përcakton në thirrje adresën e postës elektronike, si dhe adresën postare në të cilën aplikantët dorëzojnë shprehjet e interesit.

4. Pas përfundimit të afatit 15-ditor për paraqitjen e shprehjes së interesit, Ministria e

Brendshme publikon faqen zyrtare emrat e kandidatëve.

5. Brenda 45 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjeve të interesit, Komisioni i Posaçëm (në vijim “Komisioni”) kryen vlerësimin paraprak, me qëllim verifikimin e plotësisë të kushteve ligjore, të përcaktuara në nenin 4 të këtij udhëzimi. Nëse është e nevojshme, Komisioni kërkon informacione të mëtejshme prej kandidatit, institucioneve publike, apo punëdhënësit të kandidatit.

6. Në përfundim të vlerësimit paraprak, Komisioni harton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe të kandidatëve që nuk i plotësojnë këto kushte bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati dhe dokumentacionin shtesë të mbledhur nga Komisioni.

7. Komisioni merr vendim për përjashtimin e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore dhe i njofton me shkrim kandidatët e përjashtuar, në mënyrë të posaçme dhe të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit.

8. Komisioni organizon seancë dëgjimore me kandidatët dhe i njofton ata të paktën 10 ditë para seancës dëgjimore. Anëtarët e Komisionit i drejtojnë pyetje kandidatit në përputhje me kriteret e vlerësimit sipas këtij udhëzimi.

9. Anëtarët e Komisionit vlerësojnë të gjithë informacionin e vënë në dispozicion prej kandidatëve, dokumentacionin e mbledhur dhe informacionin e marrë gjatë seancës dëgjimore, në përputhje me këtë udhëzim dhe i dorëzojnë ministrit renditjen e kandidatëve, së bashku me vlerësimet me shkrim, sipas shtojcës C të këtij udhëzimi, për secilin kandidat.

Neni 3
Komisioni i Posaçëm

1. Procesi i verifikimit të përmbushjes së kriterëve dhe i vlerësimit të kandidatëve bëhet nga Komisioni i Posaçëm, me përbërjen si vijon:

a) Një nga zëvendësministrat, i caktuar nga ministri i Brendshëm, kryetar;

b) Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, anëtar;

c) Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, anëtar.

2. Vendimet për kualifikimin ose skualifikimin e anëtarëve merren me shumicën e votave, ndërsa vendimet për vlerësimin e kandidatëve merren



individualisht nga çdo anëtar i Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë udhëzim.

KREU II KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT, MËNYRA E VLERËSIMIT

Neni 4

Kushtet ligjore për emërimin e drejtorit të përgjithshëm

1. Kandidati për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës paraqet dokumente që provojnë se plotëson kushtet e parashikuara në nenin 17, të ligjit për Gardën e Republikës. Kandidati dorëzon dokumente mbështetëse për secilin prej kushteve ligjore, si më poshtë:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e rendit ose sigurisë;
- b) të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë në fushën e rendit ose sigurisë;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ç) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- d) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën.

2. Kandidatët nënshkruajnë nën përgjegjësinë e tyre deklaratat mbi kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos ketë marrë cilësinë e të pandehurit për kryerjen e një vepre penale, ose ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë e sigurimit personal;
- ç) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;
- d) të mos jetë larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit.

3. Kandidatët duhet të dorëzojnë vetëdeklarimin sipas ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Neni 5

Vlerësimi i kandidatëve

1. Kandidatët që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 4, vlerësohen dhe renditen sipas kriterëve në vijim:

a) aftësitë profesionale të kandidatit në fushën e rendit ose sigurisë, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 6 të këtij udhëzimi;

b) integriteti moral i kandidatit, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 7 të këtij udhëzimi;

c) aftësitë organizative dhe drejtuese, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 8 të këtij udhëzimi;

ç) elementet plotësuese për vlerësim, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 9 të këtij udhëzimi.

2. Në rastet kur kandidatët kanë të njëjtën meritë, vlerësohet vjetërsia në ushtrimin e profesionit dhe përvoja profesionale.

Neni 6

Vlerësimi i aftësive profesionale

1. Vlerësimi i aftësive profesionale të çdo kandidati bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) kohëzgjatja dhe përshtatshmëria e përvojës në punë me pozicionin për të cilin konkurron;

b) rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka, ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit ose sigurisë;

c) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë;

ç) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë;

d) punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore (përveç atyre që kanë shërbyer për fitimin e gradës shkencore), pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e rendit ose sigurisë.

Neni 7

Vlerësimi i integritetit moral

1. Vlerësimi i çdo kandidati në lidhje me integritetin moral bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe llogaridhënia;



b) reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale, si: besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, veprimtaritë sociale ose kulturore.

2. Vlerësimi për integritetin moral bëhet përmes dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët, dokumenteve të mbledhura nga Komisioni, të dhënave nga seancat dëgjimore, raportimeve në media, të dhënave publike ose burimeve të tjera të besueshme.

Neni 8

Vlerësimi i aftësive organizative dhe drejtuese

1. Vlerësimi i çdo kandidati për aftësitë organizative dhe drejtuese bazohet në kriteret e mëposhtme:

a) cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin sipas shtojcës A të këtij udhëzimi;

b) aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe të përgjegjësisë, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë në komunikim;

ç) aftësia për të punuar në grup dhe në mjedise multidisiplinare dhe/ose multikulturore;

d) aftësia për përfaqësim në publik.

2. Komisioni vlerëson përmbushjen e kriterëve të mësipërme bazuar në dokumentet e dorëzuara nga kandidati, të mbledhura nga Komisioni dhe të dhëna të mbledhura gjatë seancës dëgjimore me kandidatin.

3. Kandidati ka barrën për të sjellë prova që tregojnë aftësitë organizative dhe drejtuese të renditura në pikën 1 të këtij neni.

Neni 9

Elemente shtesë për vlerësim

1. Krahas kriterëve të përcaktuara në nenet 6, 7, dhe 8 të këtij udhëzimi, kandidatët mund të vlerësohen edhe për kriteret e mëposhtme:

a) mbajtja e titujve akademikë;

b) studimet dhe trajnimet afatgjata të kryera jashtë vendit jo më pak se dy javë në fushën e rendit ose sigurisë ose aftësive menaxheriale;

c) zotërimi i gjuhëve të huaja, duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.

2. Komisioni vlerëson zotërimin e gjuhëve të huaja përmes dokumenteve zyrtare të njohura të

dorëzuara dhe/ose përmes intervistës me kandidatin.

KREU III

PROCEDURA E APLIKIMIT

Neni 10

Thirrja për paraqitjen e shprehjes së interesit

1. Ministria e Brendshme shpall thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës, jo më vonë se 30 ditë nga data e shpalljes së vendit vakant.

2. Thirrja shpallet në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme dhe të Gardës së Republikës, si dhe me lajmërim në mediat e shkruara dhe audiovizive.

3. Thirrja qëndron e hapur për 15 ditë. Afati fillon nga e nesërmja e shpalljes ose e publikimit dhe përfundon në orën 23:59 të ditës së fundit. Ky afat mund të zgjatet me urdhër të ministrit të Brendshëm.

Neni 11

Shprehja e interesit

1. Kandidatët paraqesin një kërkesë me shkrim drejtuar ministrit të Brendshëm për të shprehur interesin dhe për të dëshmuar kualifikimet e tyre për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

2. Kandidati duhet të paraqesë një aplikim të plotë në mënyrë që të merret në konsideratë. Vlerësimi bëhet mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara.

3. Kërkesa me shkrim shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

a) një jetëshkrim i përditësuar;

b) një platformë personale e qëllimeve dhe objektivave që kandidati propozon të ndjekë. Ky dokument duhet të jetë punë origjinale e kandidatit dhe nuk duhet të kalojë 20 faqe, në llojin e shkrimit *Times New Roman*, madhësia 12, me një njësi hapësire mes rreshtave;

c) një vetëdeklarim sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, emëruar ose që marrin funksione publike”;

ç) dëshmi të gjendjes gjyqësore lëshuar nga organi kompetent shtetëror, e lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;



d) vërtetimin/dokumentacionin e përshtatshëm që provon përvojën e punës së kandidatit për pozicionin për të cilin konkurren;

dh) rezultatet e vlerësimit profesional dhe etik të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, apo rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit dhe sigurisë;

e) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta dhe në trajnime dhe kurse të certifikuar, brenda dhe jashtë vendit;

ë) rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë;

f) kopje të noterizuara të dëshmimeve të gjuhëve të huaja, sipas pikës 1, shkronja “c”, të nenit 9 të këtij udhëzimi, nëse ka;

g) kopje të noterizuara të gradës shkencore ose të titujve akademikë, nëse ka;

gj) kopje të vërtetimit të besueshmërisë, të marrë nga komisioni përkatës, e lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

h) dokumentin shëndetësor që dëshmon aftësinë për punë, e lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e paraqitjes së shprehjes së interesit;

j) një vetëdeklarim që kandidati ka vetëm shtetësinë shqiptare;

k) një vetëdeklarim që kandidati nuk është në konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;

l) një vetëdeklarim që kandidati nuk është larguar nga puna më parë për shkaqe disiplinore dhe që nuk ka masë disiplinore në fuqi në momentin e kandidimit;

ll) autorizimet për Ministrinë e Brendshme/Komisionin, sipas shtojës B të këtij udhëzimi.

4. Shprehja e interesit dhe të gjitha dokumentet e kërkuara duhet t'i dorëzohen Komisionit deri në datën dhe orën e përfundimit të afatit, në adresën postare ose në adresën elektronike të shënuar në thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit.

Neni 12

Publikimi i listës së aplikantëve

Pas kalimit të afatit për të paraqitur shprehje interesi, Komisioni shqyrton aplikimet dhe publikon emrat e aplikantëve në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme. Publikimi duhet të bëhet jo më vonë se 3 ditë pune pas mbylljes së thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit.

Neni 13

Informacion shtesë përveç shprehjes së interesit

1. Komisioni, kur e sheh të nevojshme, kërkon informacione të mëtejshme nga kandidatët, organet publike ose punëdhënësi i kandidatit.

2. Kërkesa duhet të përshkruajë qartë informacionin që nevojitet dhe të përcaktojë afatin dhe vendin e paraqitjes së tij.

KREU IV

PROCEDURA PËR VLERËSIMIN PARAPRAK

Neni 14

Verifikimi i kushteve ligjore

1. Komisioni shqyrton dokumentet e dorëzuara nga kandidatët dhe nga institucionet brenda 45 ditëve nga data e mbylljes së thirrjes për dorëzimin e dokumenteve, me qëllim verifikimin kushteve ligjore të parashikuara në nenin 4 të këtij udhëzimi.

2. Komisioni përcakton nëse do të kërkohet informacion shtesë nga kandidati, institucioni shtetëror ose punëdhënësi i kandidatit. Komisioni kërkon informacion shtesë në përputhje me procesin e parashikuar në nenin 13 të këtij udhëzimi.

3. Nëse Komisioni nuk merr informacion të mjaftueshëm për të përmbushur detyrën e tij për verifikimin e kriterëve ligjore, mund të vendosë një afat shtesë për të marrë informacionin e duhur.

4. Komisioni harton një listë të kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore dhe një listë të atyre që nuk plotësojnë kushtet ligjore së bashku me një raport mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe atë të mbledhur.

5. Komisioni merr vendim për përjashtimin e kandidatëve dhe njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar çdo person të përjashtuar. Njoftimet nënshkruhen nga kryetari dhe i dërgohen secilit kandidat të përjashtuar, me postë rekomandë, ditën vijuese të punës.

Neni 15

Verifikimi i integritetit të kandidatit

1. Aplikanti dorëzon bashkë me aplikimin pranë Ministrisë së Brendshme, kopjen fizike të formularit



për vetëdeklarim, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

2. Për aplikantët që plotësojnë kriteret ligjore, ministri i Brendshëm i përcjell menjëherë formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015, të plotësuar nga kandidati, në Prokurorinë e Përgjithshme. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas ligjit nr. 138/2015 bëhet publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme.

3. Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimet sipas ligjit jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e vetëdeklarimit pranë atij institucioni.

4. Komisioni mund të kryejë edhe veprimet për kërkimin e informacionit, sipas kompetencës përkatëse, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ i Shtetit, shërbimet e tjera të inteligjencës dhe prokuroria. Kandidati plotëson dhe nënshkruan autorizimin sipas shtojcës B të këtij udhëzimi, ku autorizon Komisionin të kryejë verifikimet përkatëse.

5. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të integritetit të kandidatit, Komisioni mund të kërkojë:

a) informacione shtesë nga institucionet e përmendura në këtë nen;

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, i cili, jo më vonë se 5 ditë nga marrja dijeni, duhet të paraqesë drejtpërdrejt pranë Komisionit, shpjegimet e tij dhe dokumentet mbështetës ose shprehjen e vullnetit për tërheqjen nga kandidimi.

6. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe gjetjet e përfundimet e nxjerra nga të dhënat e dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, Komisioni vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, vijon me procedurën e vlerësimit të kandidatit.

7. Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Prokurorisë së Përgjithshme, si edhe të atyre të dërguara nga institucionet e tjera të përmendura në këtë nen, Komisioni vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin përjashtimin e kandidatit, Komisioni merr vendim për përjashtimin e kandidatit dhe e njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar. Njoftimet nënshkruhen nga kryetari dhe i dërgohen secilit kandidat të përjashtuar, me postë rekomande, ditën vijuese të punës.

8. Përjashtimi vendoset edhe kur kandidati ka refuzuar të përmbushë detyrimin për të dorëzuar

formularin e vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015.

KREU V PROCEDURA PËR VLERËSIMIN NGA KOMISIONI

Neni 16

Zhvillimi i seancave dëgjimore

1. Komisioni cakton datën dhe orën e seancës dëgjimore. Seanca për secilin kandidat mbahet në praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të Komisionit.

2. Në seancën dëgjimore, i jepet fjala kandidatit, i cili ka në dispozicion 20 minuta për të bërë një prezantim.

3. Pas prezantimit, çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë t'i drejtojë pyetje kandidatit. Pyetjet do të përqendrohen në kompetencën e kandidatit në fushën e:

a) rezultateve të vlerësimit profesional të kandidatit në fushën e rendit ose të sigurisë, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 6;

b) integritetit moral të kandidatit, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 7;

c) aftësive organizative dhe drejtuese, sipas parashikimeve të detajuara në nenin 8;

ç) elementeve shtesë të vlerësimit sipas parashikimeve të detajuara në nenin 9.

5. Kandidatëve u lihet kohë e mjaftueshme në dispozicion për t'u përgjigjur për çdo pyetje.

6. Komisioni mund të kërkojë informacion shtesë nga burimet përkatëse në përputhje me nenin 13 të këtij udhëzimi.

7. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, Komisioni zhvillon një seancë të mbyllur për të vlerësuar cilësitë e secilit kandidat. Komisioni do të shqyrtojë çdo dokument të nevojshëm për vlerësimin e kandidatit.

Neni 17

Procedura e vlerësimit

Secili nga anëtarët e Komisionit do të përdorë formularin e vlerësimit në shtojcën C të këtij udhëzimi. Anëtari do të përdorë dokumentet në dispozicion dhe informacionin e dhënë gjatë seancës dëgjimore për të përfunduar vlerësimin. Anëtarët e Komisionit i dorëzojnë vlerësimet për secilin kandidat ministrit të Brendshëm.



Neni 18

Vendimarrja përfundimtare e ministrit

1. Brenda 72 orëve nga seanca e fundit dëgjimore, Komisioni përpunon të dhënat dhe harton tabelën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve. Komisioni rendit kandidatët sipas pikëve të marra, duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë.

2. Në rastet kur kandidatët kanë pikë të barabarta, ata do të listohen në bazë të vjetërsisë në profesion dhe në përvojën profesionale.

3. Në përfundim të renditjes, ministri i propozon Kryeministrit një nga kandidatët me vlerësimin më të lartë. Propozimi i ministrit shoqërohet me një relacion, i cili shpjegon procesin e ndjekur, kandidatët që u kualifikuan si dhe shkaqet për propozimin e kandidatit përkatës për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës.

**KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 19

Konflikti i interesit

Anëtari i Komisionit, që ka pengesa ligjore në kuptim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe ka konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, heq dorë nga detyrat e tij/saj në procesin e vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve. Në këtë rast, ministri zëvendëson anëtarin me një anëtar tjetër.

Neni 20

**Komunikimet jozyrtare gjatë procesit të
përzgjedhjes**

Anëtarët e Komisionit dhe kandidatët për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës duhet të shmangin komunikimet jozyrtare mes tyre, duke filluar nga data e shpalljes së vendit vakant deri në ditën e përfundimit të procesit për vlerësimin e kandidatëve.

Neni 21

Pjesëmarrja nga përfaqësitë e huaja

Përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe të Ambasadës së Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, në Tiranë, mund të marrin pjesë në seancat dëgjimore me kandidatët. Ata mund të drejtojnë pyetje gjatë seancave dëgjimore, pasi kanë mbaruar anëtarët e Komisionit.

Neni 22

**Konfidencialiteti, mbrojtja e të dhënave dhe
klasifikimi**

Procedurat e parashikuara në këtë udhëzim kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar. Dokumentet duhet të jenë të redaktuara para publikimit, në rast se përmbajnë informacion personal të kandidatëve ose informacion rreth personave të tjerë.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

**SHTOJCA A
PLATFORMA DHE VIZIONI I
KANDIDATIT PËR DREJTOR TË
PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË
REPUBLIKËS****I. Vizioni, politikat dhe strategjitë në Gardën
e Republikës gjatë mandatit**

1. Si e vlerësoni situatën në Gardën e Republikës gjatë pesë viteve të fundit (kritikat janë të vlerësueshme).

2. Listoni përparësitë kryesore tuajat si drejtor i përgjithshëm i Gardës së Republikës dhe arsyet e përzgjedhjes së tyre.

3. Evidentoni mangësitë e Gardës së Republikës dhe adresimin e zgjidhjeve.

4. Cilat janë sfidat e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës gjatë mandatit.

**II. Aftësia drejtuese dhe lidhshëmi për të
udhëhequr Gardën e Republikës gjatë periudhës së mandatit**

1. Cili është misioni dhe vizioni juaj gjatë mandatit?

2. Evidentoni vështirësitë e rolit tuaj, rreziqet dhe masat për kapërcimin e tyre.



III. Aftësitë menaxheriale gjatë periudhës së mandatit

1. Me qëllim përmbushjen e misionit dhe vizionit tuaj në krye të Gardës së Republikës listoni pesë prioritetet kryesore dhe arsyen e përzgjedhjes.

IV. Vizioni për të menaxhuar burimet njerëzore në Gardën e Republikës

Secili kandidat duhet të rendisë hapat që do të ndërmerren gjatë mandatit të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës për të përmbushur objektivat kryesore:

1. Hapat që do të ndërmerren gjatë dy viteve të para;

2. Hapat që do të ndërmerren gjatë dyvjeçarit të dytë;

3. Hapat që do të ndërmerren deri në mbarimin e mandatit.

V. Përvoja praktike në çështjet e rendit ose të sigurisë

1. Evidento përvojën e deritanishme;

2. Hapat të cilët do të ndërmerren për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut institucionin e Gardës së Republikës.

Emri Mbiemri

Nënshkrimi

Data dhe vendi i nënshkrimit _____

SHTOJCA B

AUTORIZIM

Mbi verifikimin e figurës dhe integritetit

Unë i/e nënshkruari/a (emri, atësia, mbiemri), kandidat/e për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës, autorizoj Ministrinë e Brendshme/ Komisionin e Posaçëm të kryejë verifikimin në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të figurës dhe integritetit tim, si dhe çdo shkak tjetër përjashtues.

Ky autorizim ka vlerë deri në përfundim të procesit të përzgjedhjes dhe propozimit të kandidatëve për drejtor të përgjithshëm të Gardës së Republikës, Kryeministrit.

Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna, të kryera nga Ministria e Brendshme apo persona/subjekte të autorizuarat prej tij, i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë.

Autorizuesi

Data, vendi i nënshkrimit

Emri Mbiemri, nënshkrimi

SHTOJCA C

FORMULAR

PËR VLERËSIMIN E KANDIDATIT PËR DREJTOR TË PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË REPUBLIKËS

Kandidati/ja z./znj. _____

Nr.	Komponentët dhe elementet e vlerësimit	Pikët maksimale	Pikët e akorduara	
			Për çdo element	Për komponentin
1	Vlerësimi profesional	30	X	
	Kohëzgjatja dhe rëndësia/përshtatshmëria e eksperiencës në punë me pozicionin në të cilin konkurron.			
	Rezultatet e vlerësimeve profesionale ose etike të kandidatëve në pozicionet e mëparshme, nëse ka ose rezultatet e arritura gjatë përvojave të tyre të punës që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e rendit ose sigurisë.			
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve të tyre të larta, si dhe në kurse trajnimi të certifikuar në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë.			
	Rezultatet e arritura gjatë studimeve pasuniversitare në fushën e rendit ose sigurisë.			



	Punime akademike, studime shkencore, shkrime dhe ligjërata profesionale, botime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional i kandidatit gjatë 5 viteve të fundit në fushën e rendit ose sigurisë.			
2	Vlerësimi moral dhe i integritetit	10	X	
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktivitetit të tij profesional bazuar në cilësitë morale, si: ndershmëria, përpikëria në kryerjen e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, llogaridhënia.			
	Reputacioni që kandidati gëzon në shoqëri dhe te kolegët, si rezultat i aktiviteteve të kryera gjatë kohës që nuk ushtron funksionin e tij bazuar në cilësitë morale, si: besueshmëria, paanshmëria, dinjiteti, aktivitete bamirëse ose kulturore.			
3	Vlerësimi organizativ dhe drejtues	50	X	
	Cilësia e platformës dhe vizionit që ata paraqesin, sipas shtojcës B të udhëzimit.			
	Aftësitë e provuara në marrjen e vendimeve dhe përgjegjësi, bazuar gjithashtu në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore.			
	Aftësitë në komunikim			
	Aftësia për të punuar në grup dhe në mjedisë multidisiplinare dhe/ose multikulturore.			
	Aftësia për përfaqësim në publik.			
4	Elemente shtesë për vlerësim	10	X	
	Mbajtja e titujve akademikë			
	Studime dhe trajnime afatgjata të kryera jashtë vendit, jo më pak se dy javë në fushën e rendit ose të sigurisë, ose menaxheriale.			
	Zotërimi i gjuhëve të huaja, duke i dhënë përparësi gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës.			
	TOTALI I PIKËVE	100		

Anëtar i Komisionit të Posaçëm

Emri Mbiemri

URDHËR
Nr. 96, datë 31.5.2024

**PËR CAKTIMIN E
ZËVENDËSDREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR
USHTRIMIN E KOMPETENCAVE DHE
DETYRAVE TË DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 19, të ligjit nr.

33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Caktimin e zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, Drejtues i Parë Sami Kutli, për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohen deri në emërimin e drejtorit të përgjithshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë, por jo më shumë se 6 (gjashtë) muaj, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendës drejtori i përgjithshëm i Gardës së Republikës së Shqipërisë, Drejtues i Parë Sami Kutu.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla

URDHËR
Nr. 405, datë 4.6.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MOLDAVISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Briceni*		
Cahul*		
Dubăsari*		
Edineț*		
Făleşti*		
Florești*		
Rîșcani*		
Sîngerei*		
Strășeni*		
Ungheeni*		
Glodeni*		

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha

kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Moldavisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantinë, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur, në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:



a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1

ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në



një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 207, datë 21.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Moldavisë” shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 406, datë 4.6.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E BULLGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve i patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht,

nga shteti i Bullgarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Haskovo	Haskovo*	
2	Haskovo	Simeonovgrad*	
3	Plovdiv	Brezovo*	
4	Plovdiv	Sadovo*	
5	Plovdiv	Kaloyanovo*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

1. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

3. Urdhri nr. 338, datë 10.5.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me



patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 407, datë 4.6.2024

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT
NR. 269, DATË 8.4.2024, “PËR DISA MASA
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SUEDISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikën së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 269, datë 8.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Suedisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 408, datë 4.6.2024

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.
113, DATË 14.2.2024, “PËR DISA MASA
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SLOVAKISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 113, datë 14.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Sllovakisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 409, datë 4.6.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MOLDAVISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht,

nga shteti i Moldavisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Falësi*		
2	Telenesti*		
3	Rezina*		
4	Cahul*		
5	Orhei*		

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 157, datë 4.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Moldavisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM

Nr. 96, datë 20.5.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHPK,
PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1053/1 prot., datë 16.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Ayen AS Energi’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energi” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 prot., datë 8.5.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, deri më 24.9.2024. Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 24.3.2024 për rinovimin e licencës, referuar nenit 16, pikës 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ku përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Subjekti ka bërë aplikim të ri e si e tillë afatet e licencës, në rast miratimi, do të fillojnë nga data 25.9.2024.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e



licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, e cila do të rakordohet në vijim me *statement-in* përkatës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a”; si dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shoqërinë dhe administratorin e saj.

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj;

- germa “c”: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE në kuadër të këtij aplikimi një plan biznesi për të gjithë periudhën e licencimit, jo vetëm për vitet e referuara sa më lart dhe gjithashtu ky plan biznesi nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në kontratat e bëra me dije por të jetë në formën e kërkuar i cili duhet të përmbajë përcaktime në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e projektit/ushtimit të veprimtarisë për të cilën po kërkon të licencohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 97, datë 20.5.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1054/1 prot., datë 16.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Ayen AS Energji’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen AS Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1054 prot., datë 8.5.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri ka një licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, deri më 24.9.2024. Duke qenë se shoqëria nuk aplikoi brenda datës 24.3.2024 për rinovimin e licencës, referuar kjo nenit 16, pika 1, të rregullores, ku përcaktohet se: paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo me vonë se 6 muaj para



përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë. Shoqëria ka bërë aplikim të ri dhe afatet e licencës në rast miratimi do të fillojnë nga data 25.9.2024.

- Shoqëria e kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, e cila do të rakordohet në vijim me *statement-in* përkatës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a”; si dhe pikën 2.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shoqërinë dhe administratorin e saj;

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj;

- germa “c”: aplikuesi duhet të përcjellë në ERE planin e biznesit dedikuar veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike, për të gjithë periudhën e licencimit, e gjithashtu ky plan biznesi nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në kontratat e bëra me dije por të jetë në formën e kërkuar, i cili duhet të përmbajë përcaktime, në lidhje me parashikimin vjetor të kostove, shitjeve, të ardhurave dhe financimin e projektit/ushtrimit të veprimtarisë për të cilën po kërkon të licencohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Ayen AS Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasit Thomaidha Tiri dhe Mikel Tiri kërkojnë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Aleksandër Tiri.

KËRKUES
Thomaidha dhe Mikel Tiri

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 80 lekë